

VENDIM
Nr.321, datë 18.4.2020

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS PËR LOTIN 1, ME OBJEKT “FURNIZIM ME PRODUKTE LETRE NJËPËRDORIMSHE TË TIPIT LETËR RULO TAVOLINE DHE LETËR HIGJENIKE, PËR PACIENTËT ME COVID-19 DHE PERSONELIN MJEKËSOR”, NË QSUT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 1, të kreut VII, të vendimit nr.203, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e kontratës për lotin 1, me objekt “Furnizim me produkte letre njëpërdorimshe të tipit letër rulo tavoline dhe letër higjienike, për pacientët me COVID-19 dhe personelin mjekësor” në QSUT, me palë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe operatorin ekonomik “EUROMEGA 2010”, sh.p.k., të zhvilluar me procedurën e drejtpërdrejtë, me objekt “Produkte letre si dhe spostimin e sistemit të dializës nga pediatria e specialiteteve të QSUT-së te godina e spitalit infektiv në QSUT (Shërbimi i alergologjisë, për pacientët dializantë të prekur me COVID-19)”, ndarë në dy lote, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama